



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal i mbajtur më 23 nëntor 2020, në mbledhjen e XXXVIII (tridhjetë e tetë) të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.

Mbledhja filloi në orën 10;15 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve në ish ndërtesën e Komunës.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët/et e Kuvendit të Komunës, (Lista e nënshkrimeve).

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje të pranishëm ishin Drejtorët e Drejtorive të Komunës së Podujevës, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të OJQ-ve dhe përfaqësues të LMT KFOR – Podujevë, si dhe një numër i qytetarëve dhe zyrtarëve komunal.

Rendi i Ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit dhe iu dëshiroi mirëseardhje në këtë seancë e cila gjithashtu po mbahet në kushte dhe masa jo të zakonshme për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19.

Konstatoi kuorumin dhe i njoftoj për mungesat e këshilltarëve për të cilët tha se më kanë njoftuar se nuk mund të marrin pjesë në këtë mbledhje. Shtoi konsideroj se thirrjen dhe materialet i keni marrë me kohë, po ashtu edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së e mbajtur një ditë më parë, andaj urdhëroni nëse keni diçka rreth rendit të ditës.

Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës.

1. Propozim vendimi për rialokimin e buxhetit të Komunës për vitin 2020

z.Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, e paraqit fjalën hyrëse rreth propozim vendimit në fjalë, ndër të tjera theksoi, propozim vendimi për rialokim të buxhetit është i bazuar në nenin 16 pika 1 të Ligjit të buxhetit të Republikës së Kosovës si dhe nenin 30 pika 2 të Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Sa i përket ndryshimeve të shumave të ndara në projekte kapitale n'kuadër të nën programit, Drejtoritë përkatëse kanë bërë kërkesë për rialokim bazuar në kontratat e lidhura për projekte kapitale e që mjetet që janë tepricë nga këto kontrata propozohen të rialokohen në projektet të cilat kanë mjete të pa mjaftueshme për pagesë, bazuar në punët e kryera në teren gjatë këtij viti.

Propozimet për rialokim të mjeteve buxhetore kanë ardhë nga; Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DPUMM në shumë 196,754.86€, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS në shumë 19,625.00€ dhe Drejtoria e Arsimit-DKA në shumë 22,237.94€.

Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit është bazuar në këto vlerësime: buxheti për asfaltimin e rrugëve në fshatrat Zakut, Letanc, Doberdol, Bajqinë që në total është 120,000.00€, vlera e kontratës është 99,000.00€ loto e përbashkët për të gjitha projektet, prandaj teprica në shumën prej 10,996.09€ për asfaltimin e disa rrugëve në fshatin Zakut dhe 10,000.00€ për asfaltimin e disa rrugëve në fshatin Letanc rialokohen sipas propozim vendimit në fjalë. Buxheti për asfaltimin e rrugëve në fshatrat Surkish, Orllan, Gllamnik është 165,000.00€, vlera e kontratës është 127,298.82 €-loto e përbashkët, prandaj shuma prej 32,251.18€ asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Surkish kërkohet të rialokohet sipas propozim vendimit. Mandej buxheti për asfaltimin e rrugëve në fshatrat Pakashticë, Metehi, Revuq është 105,000.00 €, vlera e kontratës është 101,315.96€ loto e përbashkët, prandaj shuma prej 120,43.68€ kërkohet të rialokohen në projekte sipas propozim vendimit përkatës.

Buxheti për asfaltimin e rrugëve të fshatrave Penuhë, Siboc, Godishnjak është 110,000.00€ vlera e kontratës është 76,631.98€ loto e përbashkët prandaj shuma prej 33,362.02 € kërkohet të rialokohet po ashtu në projekte sipas propozim vendimit. Mandej kemi buxhetin për asfaltimin e rrugëve të fshatrave Halabak, Sallabaj, Ternavë në shumë 130.000.00€ vlera e kontratës 96,442.49€ loto e përbashkët, andaj shuma prej 30,477.70€ për asfaltim të disa rrugëve në fshatin Halabak kërkohet të rialokohet. Buxheti për asfaltimin e rrugëve Kaqibeg, Gerdok, Lluga është 110,000.00€ vlera e kontratës 88,826.87€ loto e përbashkët, andaj shuma prej 21,173.13€ për asfaltimi i disa rrugëve në Kaqibeg kërkohet të rialokohen. Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Bollopoj është vazhdim i vitit 2019, vlera e kontratës është 129,000.00€ andaj shuma prej 20,938.85€ kërkohet të rialokohet. Buxheti për asfaltimin e disa rrugëve në fshatrat Peran, Bradash në shumë 125,000.00€ vlera e kontratës 88,693.79€ loto e përbashkët, prandaj shuma prej 36,306.21€, asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Peran kërkohet të rialokohet sipas propozim vendimit.

Drejtoria e Arsimit ka kërkuar rialokim të mjeteve tepricë nga projekti i shkollës fillore “Elfir Behrami” në fshatin Metehi tek shkolla “Ali Ajeti” në fshati Balloc e cila ka mungesë por që është projekt 2 vjeçar.

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, bazuar në kontratat e projektit për ndërtimin e Ambulancës së Mjekësisë Familjare në fshatin Dumnicë, buxheti i planifikuar 50,000.00€, kontrata 42,435.00€ si dhe nga projekti për ngrohje nga energjia solare, buxheti 50,000.00€, kontrata 37,940.00€, ndërsa teprica të rialokohet në projektin pajisje mjekësore. Prandaj duke u bazuar në këto vlerësime të Drejtorive përkatëse kërkoj nga ju të nderuar këshilltar që të apromoni këtë propozim vendim të rialokimit.

z.Hasan Ajeti, theksoi, Grupi i këshilltarëve të Kuvendit nga radhët e LDK-së mbështet propozim-vendimin për rialokimin e mjeteve buxhetore të Komunës së Podujevës për vitin 2020, rialokim të cilin e shpjegoi drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, madje për çdo pikë veç e veç, prandaj meqë ky rialokim rregullon mjete buxhetore për t’i shpenzuar dhe i cili është në pajtim edhe me legjislacionin në fuqi dhe si të tillë ne si Grup e mbështesim.

z.Vendenis Lahu, theksoi, miratimi i buxhetit vjetor dhe rishikimi i tij në muajin qershor me qëllim të përmirësimit të lëshimeve eventuale në planifikim dhe për të buxhetuar projekte tjera të dala si nevojë në një kohë pas miratimit të këtij buxheti janë procedurat standarde kur behet fjalë për këtë çështje. Ky propozim vendim që na është sjell sot është qartazi i motivuar politikisht dhe për qëllime elektorale, po shtroni asfalt për ta evituar humbjen, është e pa shembull që një Komunë vetëm një muaj para mbylljes së pagesave dhe vitit fiskal të bëjë rialokim të buxhetit vjetor.

Ky propozim vendim i ka 3 elemente, atë elektorale për blerje të tërthortë të votave me qëllim të ndikimit në rezultate në procesin zgjedhor në të cilin jemi, mashtrim të qytetareve, dhe elementi i tretë është keqpërdorim i buxhetit përmes një veprimi të kundërligjshëm, këto mjete siç keni thënë

kanë tepruar nga programet tjera dhe duke qenë se bëhet fjalë për mjete nga granti qeveritar këto mjete do të kthehen në buxhetin e shtetit si suficit, prandaj kjo tregon për paaftësi për të planifikuar në mënyrë adekuate dhe në përputhje me prioritetet të cilat vet i keni caktuar, e rrjedhimisht në mënyrë të pa shmangshme, pamundësi për të realizuar shpenzime. Në anën tjetër po të shikosh se në çfarë projektesh janë planifikuar që të rialokohet i gjithë ky planifikim pa konkretizim të përmasave të projekteve, madje edhe pa konkretizim të emërimit të projekteve, por duke lënë përgjegjësinë si shembull, disa rrugë në fshatin NN e argumenton atë që thash me herët, po shtroni asfalt në tentim për të evituar humbjen, ndërsa shumat prej 10,000.00€ e 20,000.00€ në disa projekte me shumë u shkojnë për shtati përmasave të rrugëve private e oborreve që po shtrohen sesa rrugëve që po proklamohen. Në vitin 2019 kur u realizua vetëm 68% e buxhetit për investime kapitale, kurse 90% e atij buxheti të realizuar u realizua vetëm në dy muajt e fundit, ju kemi kritikuar vazhdimisht se me ritmin e procedimit të projekteve nuk do të mund t'i realizoni objektivat e parapara, ndërsa përgjigjja juaj atë kohë ishte se janë proceduar standarde të cilat marrin kohë. Ndërsa tani në këtë kërkesë për rialokim të buxhetit ju keni vetëm një muaj, pra po pretendoni që këtë ta bëni për një muaj, unë shtroj pyetjen a e kishit gabim atëherë kur thoshit se marrin kohë shumë, apo e keni gabim tani kur po thoni se e bëni për një muaj, unë po iu them se kishit gabim atëherë dhe e keni gabim edhe sot, për një muaj sa kanë mbetur nuk mund të ndërmerret asnjë veprim procedural e lëre më të realizohen projekte. Nuk keni projekte të hartuara kurse procedurat e prokurimit marrin kohë, minimalisht 60 deri 90 ditë, pra asnjë muaj, siç pretendoni tani por as 7-8 muaj sa u morën vitin e kaluar.

Si mendoni se mund t'i shpenzoni këto mjete brenda një kohe kaq të shkurtër, përveçse nëse i ekzekutoni në kundërshtim me ligjet në fuqi. Neni 29 i Ligjit mbi menaxhimin e financave publike e sanksionon këtë gjë, ai thotë se në rast mos ekzekutimit së mjeteve të ndara nga grantet qeveritare nga ana e Komunës deri më datën 31 dhjetor, ato mjete do t'i kthehen buxhetit të Kosovës si suficit i buxhetit Komunal. Mjetet të cilat ju po kërkon t'i rialokoni janë pra pikërisht mjetet nga grantet qeveritare. Në mes të pandemisë buxheti i tepruar nga keq planifikimi dhe mos rialokimi i tyre gjatë rishikimit, por në mbyllje të vitit financiar të ridestinohet në asfaltim rrugësh është i pa pranueshëm, ky ridestitim do të kishte kuptim vetëm e vetëm për raste urgjente për emergjencë shëndetësore sikur mund të ishin blerja e oksigjenit i cili shpesh herë mungon në QKMF-në – Podujevë, bombola, shtretër, ose ndonjë makinë ambulancë, ndërsa kështu siç është propozuar ky rialokim është edhe në kundërshtim me Ligjin mbi Financat Publike, dhe kryekëput në funksion të fushatës zgjedhore andaj edhe ky rialokim është rialokim i asfaltit prandaj për ne është i pa pranueshëm.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, fillimisht paraqes shqetësim sa i përket kushteve për punë të anëtarëve të Kuvendit sepse jemi duke mbajtur mbledhje në këtë sallë që nuk i plotëson kushtet duke përfshirë edhe sezonin e dimrit që kemi hyrë.

Sa i përket temës, mendoj që drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF z.Isuf Latifi e paraqit kërkesën për rialokim të mjeteve buxhetore që Drejtoritë përkatëse e kanë bërë në DBF për projekte të caktuara, por në bazë të rendit dhe rregullave është dashur që drejtorët e atyre Drejtorive sot në Kuvend të japin arsyeshmëri para nesh këtu sepse ky dokument do të hedhet në votim, kurse është shqetësuese sepse dy prej Drejtorive përkatëse për momentin janë pa drejtues/drejtor, aq sa unë jam në dijeni, fjala është për Drejtorinë e shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale si dhe Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit të cilat kanë kërkuar rialokim të mjeteve por që tani nuk kanë drejtor tani, ndërsa këto planifikime i kanë bërë ish drejtorët dhe janë shkarkuar për arsye se këto projekte nuk kanë qenë të planifikuara apo këto i kanë bërë zyrtarët dhe drejtorët e që ndoshta nuk i kanë pranuar, dhe janë shkarkuar, dhe pastaj nuk kanë pranuar, kjo është shumë e rëndësishme. Prandaj për fillim, para se të hymë në debat, nëse dikush nga Ekzekutivi apo Drejtoritë përkatëse mund të na jep arsyeshmerinë e projekteve, nëse nuk ka atëherë mund ta vazhdojmë

debatin, mandej si pyetje tjetër është që me sa kam parë unë edhe po të dalim tani nga kjo sallë të gjithë së bashku si mazhorancë dhe opozitë, t'i shikojmë këto projekte të infrastrukturës.

Është shumë e vërtetë që shtrimi i asfaltit ka ndodhur në prona private tani e kam një pyetje direkte për z.Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, a i ke kaluar këto prona në pronë publike, për arsye se ligji parasheh që rrugët edhe nëse janë prona private të behet kërkesa dhe të kalojnë në pronësi publike për tu asfaltuar dhe për të hyrë në infrastrukturë shtetërore e që konsideroj se kjo nuk ka ndodh mirëpo unë po pyeti edhe pse e di që përgjigja është jo, por se si është bërë ashtu është mirë dikush nga ju të na shpjegoj, tani me vetëdije apo pa vetëdije ne mundemi me shkel edhe ligjin për dëshirën e dikujt por nuk është mirë të shkelet ligji, madje madje në këtë kohë fushate të gjitha subjektet politike po “qojnë pluhur” duke thënë që ne jemi kështu, ata janë ashtu, për të qeverisur duhet të këtë rregull, për të marr votë në Kuvend komunal të shumicës duhet pasur një rregull, që opozita mos me mujt me thënë asgjë e të ngjashme.

Tani kjo qeverisje lokale, në kohë pandemie në momentet më të rrezikshme me ngritjen e numrit më të madh është pa drejtor të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, është pa drejtor të QKMF-së edhe pse është emëruar dikush, unë e di që aty së paku prej vijës zyrtare ka për të ardhur, mirëpo shtrohet pyetja se kush i ka bërë kërkesat e rialokimit të mjeteve për shëndetësi, ne e dimë që edhe projektin për sheshin nuk e ka nënshkruar drejtori i kaluar i urbanizimit por e ka nënshkruar z.Durim Salihu drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit, prandaj edhe për këtë pyes kush i lejon këto gjëra/nënshkrime, e që tani kjo është shqetësuese për arsye se ne këtu të gjithë po thirremi në ligj dhe në rregulla si dhe po pretendojmë të gjitha partitë politike të marrin pushtet me datën 29 dhjetor duke u thirrë në vazhdim, pastaj në ndryshim, mirëpo në këtë mënyrë nuk do të mund të vazhdojnë askush kushdo qoftë. Kështu që i nderuari Kryesues i Kuvendit unë i kam shikuar disa prej rrugëve që u ceken këtu, në fshatin Batllavë dhe Llapashticë, dhe nëse ka gatishmëri dikush nga Drejtoria përkatëse mund t'i thërrasim mediat dhe të dalim në vendin e ngjarjes dhe mund të shohim që asfalti është shtruar në pronë private, nëse drejtori i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë mund ta argumentoj me dokument që është bërë kërkesa që prona të kalojë në pronë publike, atëherë jemi në rregull dhe ne vetëm mund të konstatojmë me një dokument prej Drejtorisë përkatëse, mirëpo sa jam në dijeni nuk ka ndodhur një gjë e tillë.

Nëse drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik z.Bunjamin Hoti (i emëruar pas të larguarit nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale), merr përgjegjësi për shëndetësinë dhe gjendjen në Komunën e Podujevës duhet të dal dhe të tregoj këtu, e them këtë sepse sa jam në dijeni i përmenduri është drejtor i dy Drejtorive të cekura, fusha të cilat nuk kanë të bëjnë asgjë mes vete dhe janë diametralisht të largëta me gjendjen të cilën jemi, po ashtu edhe z.Durim Salihu nënshkruan si drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit dhe inspekton punën në Komunën e Podujevës për çfarëdo qoftë me inspektorët e tij, por nuk është që të nënshkruaj punën e dikujt tjetër.

Pra unë vetëm dua të them që këto mjete që janë propozuar për rialokim, tani ne nuk mund t'i miratojmë në këtë Kuvend, kur kemi parasysh që kërkesat janë bërë nga zyrtarë të cilët kanë qenë në ato Drejtoria, madje as nuk e kanë ditur fare çfarë është duke ndodhur me letra, unë e di që këtu të drejtë fjale kanë asamblistët, kanë drejtorët e Drejtorive, mirëpo nëse dikush është duke e zëvendësuar ish drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit z.Hamdi Jaha, ai e ka të drejtën të merr fjalën dhe të arsyetoj, sepse këto mjete nuk i ka kërkuar drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, ata e kanë dërguar kërkesën tek ky, ky mundet me thënë këto mjete i kanë kërkuar këto drejtori, por arsyeshmërinë e projekteve e bëjnë Drejtoritë përkatëse, tani ne nuk mundemi këtu të planifikojmë mjete të bartjes/rialokimit për shëndetësi ashtu siç i ka planifikuar dikush tjetër, ndërsa për gjendjen me shëndetësi, jo vetëm këtu por në nivel vendi madje edhe në nivel rajoni jemi në dijeni të gjithë që është e keqe.

Me rritje të numrit të të infektuarve dhe me raste të vdekjeve është e pa arsyeshme që në këtë gjendje momentale që jemi Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të jetë pa drejtor, pastaj edhe QKMF-ja pa drejtor e që kjo e tregon më se miri se pse ne jemi kundër këtij rialokimi, jo kundër projekteve. Nëse Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë mundet me një dokument të arsyetoj që rrugët e shtruara në prona private/oborre (politike) janë të arsyeshme unë i pari i jap votën për, nëse nuk mundet, votën e jap kundër madje edhe të Grupit të këshilltarëve të subjektit që i takoj, kështu që i nderuari Kryesues i Kuvendit unë pres që nga këto dy Drejtori sidomos nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit si dhe ajo e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, pasi që drejtori i Drejtorisë së Arsimit është këtu prezent, të tregohet arsyeshmëria dhe të paraqiten dokumente të cilat i kërkuam, për arsye sepse ne kemi për të votuar këtë dokument dhe nuk do të thotë që është punuar diçka dhe me qenë kundër por unë mendoj që është marr votë unifikuese nga të gjitha partive kur është dashtë, por tani është moment jo i mirë sepse jemi edhe në fushatë zgjedhore dhe dikush mund të mendoj që po bëjmë fushat, por nuk është fushatë kjo sepse ne nuk mund ta mbulojmë rastin që Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale është pa drejtor në kohën kur jemi me në gjendjen më të rëndë shëndetësore, e që ai drejtor ka mund të shkarkohet për dy arsye, por ka mund të emërohet menjëherë drejtor i ri prej LDK-së sepse aty nuk emërohen prej subjekteve tjera, është shkarkuar për mos pajtim të gjendjes aktuale apo është shkarkuar për keqpërdorim, a është shkarkuar z.Hamdi Jaha për mospajtim dhe mos pranim të gjendjes së gurëve në shesh, të cilët janë plasaritë ende pa u shtruar, dhe nuk e ka nënshkruar materialin, a është shkarkuar për keqpërdorim, që të dyja janë shumë me rëndësi kështu që është përgjegjësi e juaja, andaj është mirë që para hedhjes në votim dikush nga drejtorët të jep një sqarim arsyeshmerinë për mjetet e kërkuara.

z.Avni Fetahu, theksoi, fillimisht më bënë përshtypje kjo fraza e njohur prej Ekzekutivit që po e bëjmë rialokimin duke u bazuar në ligj, ndërsa kur ligji juve ju obligon t'i planifikoni mirë mjetet buxhetore dhe t'i ekzekutoni dhe raportoni ju një gjë te tillë nuk po e bëni deri më tani, por vetëm renditen një varg lokalitetesh siç është rasti duke filluar nga fshatrat Zakut, Peran, Letanc, Bollopojë, thua se nuk kanë pasur nevojë ato vendbanime për mjete financiare dhe t'i orientoni nga e vlerësoni ju që jeni keq me vota, kjo është e pa kuptimtë në këtë kohë fushate dhe një pjesë bukur e madhe e këtyre mjeteve të shkojnë për vazhdimin e ndërtimit të lumit llap e që nuk jemi kundër por besoni se që 20 vite, 2 kilometra janë ndërtuar deri me tani, kjo është e pa kuptimtë dhe në të njëjtën kohë nëse dikush mundet të dal të tregoj se sa është investuar në këtë drejtim prej mbas lufte, përkatësisht në ndërtimin e lumit llap, të marrë fjalën dhe të na tregoj, unë nuk e di që dikush e din këtë, por edhe sikur ky rialokim i mjeteve të ish bërë dhe realizuar sipas procedurave të rregullta dhe të ndërtohet një herë e mirë dhe mos të intervenohet në vazhdimësi, sërish hallall ju qoftë, mirëpo ne jemi të vetëdijshëm se çfarë cilësie e punëve është duke u kryer dhe e gjithë kjo çka është me e keqja është duke i kushtuar qytetarit të Komunës së Podujevës, është duke i kushtuar taksapaguesve tanë, është duke i kushtuar bizneseve tona, kurse në kurriz të krejt këtyre rialokimeve po përfitojnë vetëm këta që e kanë pushtetin. Paramendoni të nderuar qytetarë me pas një qeverisje serioze që i planifikon mirë detyrat dhe që i ekzekuton ashtu siç e parasheh ligji dhe mbi të gjitha mbikëqyrë me seriozitetin më të lartë të mundshëm, a do të kishim nevojë të intervenojmë dhe të “lavrojmë” rrugët e Podujevës vit për vit, e që është e pa kuptimtë.

Ky rialokim në këtë kohë fushate zgjedhore nuk tregon asgjë tjetër veç se përpjekjet e juaja të fundit për ta blerë votën e qytetarëve mirëpo kjo nuk do t'iu ndezë sepse qytetarët janë vetëdijesuar dhe kanë për t'jua treguar vendin ku e meritoni, sepse qytetarët duhet t'i trajtoni me dinjitet në vazhdimësi me drejtësi, e jo me padrejtësi siç po ndodh e rëndomtë. Se ky Ekzekutiv me një Nënkyetar të dirigjuar nga jashtë dhe me një menaxher të prokurimit të komprometuar publikisht përmes videos deri më tani, të nderuar asambleist dhe ju qytetar të Komunës së Podujevës i kanë

realizuar 27 kontrata jo burimore që kapin vlerën prej 955,127.00€ pra afër 1 milion euro, e për kureshtjen e juaj kontratat jo burimore janë për t'i eliminuar operatorët tjerë ekonomik, pra me u ulë në zyrë dhe me bë pazare vetëm me një operator ekonomik kjo është e turpshme çka është duke ndodhur. Të gjitha këto aktivitete të gjitha këto kontrata jo burimore, këto nënshkruhen prej Nënkyetarit, nënshkruhen prej drejtorit të Buxhetit dhe Financave, dhe nënshkruhen edhe nga menaxheri i famshëm i prokurimit z.Rasim Fejza, i njohur për publikun e Podujevës por edhe me gjerë. Paramendoni Komuna e Podujevës është e 33-ta në listë sa i përket transparencës, ndërsa ishte dalë e para për nga realizimi i kontratave jo burimore, 27 kontrata gjithsej, asnjë komunë nuk e gjeni kështu, vetëm këtë vit ekzistojnë 3 kontrata për Desinfektim, Dezistektim dhe Deratizim-DDD, fillimisht është nënshkruar kontrata jo burimore me një kompani e cila është e njohur edhe për publikun dhe e cila që prej fillimit, punë kryesore dhe parësore e ka pasur këtë DDD-ne, dhe vlera e kontratës është 93,529.63€ (centat e famshëm të tyre), mandej është nënshkruar edhe kontrata kornizë në vlerë prej 458,220.00€ pra afër gjysmë milion euro, e që në kushte normale kontrata kornizë është dashur të vazhdoj edhe në vitet e ardhshme, pra nuk kanë pasur nevojë që të nënshkruajnë edhe një kontratë tjetër në vlerë prej 149,909.00€ ku e gjithë vlera e përbashkët e tyre ishte rreth 700,000.00€ e planifikuar për të realizuar DDD-në, përkatësisht 701,659.27 €, kurse ne e dimë se çfarë cilësie ka ajo dhe çfarë sasive është bërë. Besoni se në këtë shumë prej 700,000.00€ e kam një përshtypje që edhe flotën e aviacionit po ta lëshonim në Llap nuk do të na kishte kushtuar më shtrenjtë, dhe po t'i thonim dezinfektoje gjithë Llapin, më shtrenjtë nuk do të kishte kushtuar sesa kjo që është duke u bërë, ndërsa për të gjithë këtë investim nuk din askush të tregoj se cilat janë efektet e kësaj spërkatje, dhe për kureshtjen e juaj ditën e diele personat që spërkatnin me këtë DDD edhe pa maska madje spërkatnin e që njerit prej tyre i thash që ta vë maskën por më tha mos ke dert se kjo asgjë nuk bënë vetëm sa për ta hekur pluhurin ngapak se asgjë nuk bënë.

Kështu që për fund mund të them se kjo lidhet edhe me rialokim, prej 27 kontratave që janë të gjitha një burimore të cilat janë me fakte konkrete që do t'i marrin edhe mediat, në mesin e këtyre kompanive ishte edhe një kompani "multibiznes" sepse e kanë gjetur Nënkyetarin, drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave edhe menaxherin e famshëm të prokurimit që nënshkruan dhe kompani të tilla multibiznes, dhe janë bërë biznesmenë, kështu që e vetmja formë është që ju të shkoni në shtëpi e pastaj pasi që te shkoni te shtëpia duhet me ju dergu edhe te daj të pak.

z.Isuf Latifi, drejtor i DBF, theksoi, kjo foltore nganjëherë po shfrytëzohet për të mirë e nganjëherë për të keq, por unë kërkoja fjalën vetëm për sqarim, jo për replikë e as t'ju tregoj se kush është i mençur e kush me pak i mençur. Ky propozim për rialokim ka mbështetje të plotë ligjore në Ligjin mbi menaxhimin e financave publike, rialokimi nuk përcaktohet se në cilën periudhë kohore behet, por mund të bëhet brenda vitit fiskal/kalendarik, mundësia e rialokimit të buxhetit është deri në 15% kur e miraton Kuvendi i Komunës dhe e aprovon Ministri i Financave, përqindje kjo sipas këtij propozim vendimi që është shumë me e vogël se sa ajo që e lejon ligji, sepse si tërësi për rialokim lejohet deri në 25% me miratim të Kuvendit Komunal dhe aprovim të Qeverisë së Republikës së Kosovës pa asnjë problem, mirëpo ligji e lejon dhe rialokimin mbi 25% vetëm por duhet të kaloj në aprovim edhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës, kështu që ky rialokim ka bazë të plotë ligjore dhe nuk është në kundërshtim me ligjin dhe as nuk ka problem me procedurat ligjore për shkak se të gjitha mjetet të cilat po hiqen nga projektet në fjalë shkojnë tek projektet të cilat kanë kontratë dhe nuk iu duhet asnjë procedure ligjore, pra vetëm kontratat të cilat janë të nënshkruara duhet të argumentohen me raport për punët e kryera dhe me marr pagesën pas aprovimit të Kuvendit të Komunës dhe aprovimit nga Ministri i Financave, pra vetëm kjo si procedurë duhet të kryehet dhe asgjë tjetër nuk ka.

Sa i përket asaj që u cek se është nënshkrimi i drejtorit të Drejtorisë së Inspeksionit z.Durim Salihu, ju sqaroj se nuk nënshkruan Durimi në ato projekte të cilat u tha, përfitues të projekteve dhe të këtyre që po mendohet me u ndërtua me këtë rialokim janë vetëm qytetaret dhe askush tjetër, vetëm qytetaret e Komunës së Podujevës, pastaj unë jam këtu për disa mandate radhazi dhe nuk mund ta gjej askush një kontratë që Isuf Latifi ka nënshkruar ose që ka nënshkrim në kontratë, pra ajo që u tha është 100% e pavërtetë dhe do të jetë ashtu sa unë të jem drejtor, kurrë nuk do të përzihem tek kontratat, kurrë nuk do të nënshkruaj e as kurrë nuk kam nënshkruar, të gjendet një nënshkrim i imi në ndonjë kontratë unë menjëherë po jap përgjegjësi morale, politike, materiale dhe ligjore para juve, nëse brenda këtyre viteve sa është Isuf Latifi drejtor i Drejtorisë së Buxhetit Financave ka nënshkruar kontratë ose aneks kontratë, dhe unë jam këtu para juve të jap përgjegjësi, por absolutisht nuk është e vërtetë që është në kompetencë të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave të nënshkruaj kontrata, nuk është detyrë, nuk është përgjegjësi dhe nuk është në autoritet, por kompetent është Kryetari i Komunës, menaxheri i prokurimit, por jo e Drejtoritë, pra kjo është vetëm sa për kureshtjen tuaj nëse aq të drejt keni ju VV-ja, madje ju e keni pushtetin në Prizren ku 3 drejtorë të juaj janë në afëri për kontrata të nënshkruara pa vend, dhe askush nuk iu ka thënë asgjë, 3 drejtorë janë të akuzuar janë të suspenduar nga puna për shkak se kanë nënshkruar kontrata të cilat nuk i plotësojnë kushtet ligjore dhe nuk parashihen me ligj, kështu që të mos bëjmë fushat sot ju lutem, jemi këtu për rialokim, për ose kundër, këtu janë vetëm dy mundësi, jeni për ta aprovuar apo nuk jeni, nuk ka tjera, ndërsa sapo të dalim nga këtu, menjëherë mund vazhdojmë me fushatë.

z.Bajram Ajeti, theksoi, t'ju them të drejtën nuk desha të dal fare të flas sepse edhe ato që i tha kryesuesi i grupit i asambleistëve të VV-së por edhe ato që i tha z.Avni Fetahu unë mendoj që e kanë përmbledhur të gjithë problematiken e kësaj çështje të cilën mendoj që po e trajtojmë sot, megjithatë pak u përmend VV-ja nga parafolësi z.Isuf Latifi dhe nuk pata mundësi tjetër veç se të dal sepse po e shoh që jeni zverdhur nga fytyra, po e shoh që jeni keq sepse të flasësh për rialokimin është çështje ligjore, është e vërtetë ajo është çështje procedurale, por më duket më shumë e keni zotëri Latifi keni që t'i kryeni këto borxhe që i keni shtruar ato oborre e ara, keni gërryer asfalt, sesa që është një rialokim e që kjo është diçka që ju po e mbani fshehur, mos rastësisht i keni drejtorët përgjegjës të cilët i keni shkarkuar ndoshta që keni rënë në kundërshtim, nuk e di por ndoshta që siç e tha edhe z.Rafet Llapashtica që nuk jeni pajtuar rreth cilësive të punëve që po i kryejnë, mirë është ata nëse kanë bërë diçka të mirë dhe në interes të qytetareve iu ka bërë e padrejtë, por megjithatë nuk e dini se i keni bërë dëm veti e jo neve, përkundrazi na keni sjell dobi të reja dhe një forcë shtesë që VV-ja të i fitoj zgjedhjet, më vie keq por nuk do ta pranoni lehtë, megjithatë kjo është dialektike, kështu që sa për rialokim unë mendoj që është bërë për të larë borxhet ose të nxjerrin një diçka që të mundoheni t'i trullosni të shkretët që janë në nevojë dhe qytetarët të cilët kanë halle, mirëpo ata të cilët ju i manipuloni dhe luani me ta unë mendoj që ajo që sot po bëni ka qenë e padrejtë me vendos rialokimin së pari në Kuvend sepse është dita e parë e hapjes së fushatës, dhe me këtë ju mundoheni të bëni një propagandë, një akt të cilin dilni në teren dhe t'iu thoni se edhe juve kemi për tua shtruar asfaltin sepse i kemi rialokuar mjetet, prandaj unë mendoj që me të drejtë edhe kryesuesi ynë i Grupit të asamblistëve u përcaktua që ky rialokim nga Grupi i asamblistëve të LVV-së dhe jo vetëm i tyre, nuk do të votohet.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, këtu jemi mbledhur në Kuvendin e Komunës dhe merremi me çështje të Kuvendit pasi që edhe për këtë çështje jemi këtu, pra për çështje Kuvendi, e jo fushatë.

z.Agim Behluli, theksoi, unë vetëm desha të bëjë një vërejtje të vogël të gjithëve në përgjithësi sepse po flasim shumë me nervozizëm, e keni marr paksa si me vrull (gjoks), janë zgjedhjet dhe mirë që janë, ne jemi këtu të gjithë qytetarë të Komunës së Podujevës, edhe në qoftë se janë bërë këto investime si pa rend e si me rend janë bërë në Podujevë, e jo në ndonjë komunë tjetër, edhe në qoftë

se jemi vonuar pak, ju po na akuzoni pse nuk keni punuar, tash po na akuzoni edhe pse keni punuar, andaj goxha problem të ju biem në fije. Nuk jemi zbehur ashtu siç u tha, madje unë do të jem ai i pari që kam për të ardhë t'juaj uroj fitoren nëse veç fitoni, prandaj këtu jemi, kështu që më ngadalë se njerëz jemi të gjithë. Po e thoni janë është shtruar asfalt në oborre, mirëpo nuk e di a po e dini që ka njerëz që kanë para por të cilëve iu ka shkuar rruga me asfalt deri tek dyert, por që pastaj kanë paguar për të ju shtruar asfalti, kush ka argumente që dikujt ju ka shtruar le të dal dhe të na tregoj kush është ai, edhe në qoftë se iu ka shtruar ndokujt pak asfalt nuk është bërë asgjë, mos i merrni me nervozë, por nëse ka dikush argumente që dikujt i është shtruar asfalt 100 metër le të dal të tregoj, të shkojmë dhe ta vizitojmë se kush është ai.

z.Pajtim Balaj, theksoi, kolegu nga radhët e LDK-së kërkoj të dal të jap ndonjë shembull konkret, ndonjë argument/fakt, nuk kam fakt çka ai kërkoj, por kam fakt për punët që nuk janë kryer, shembull gjatë vizitave që i kemi bërë këto ditë me theks në fshatin Dobratin, e kam parë që është një kompani për grumbullimin e mjedrave dhe frutave të malit e cila ka 20 të punësuar dhe rreth 100 bujq që dërgojnë produktet e tyre aty, mirëpo nuk i është shtruar rruga sepse i takon një grupi tjetër politik, dhe nuk pranon të bëjnë pazare për vota në kohe fushate.

z.Isuf Latifi, drejtor i DBF, theksoi, është mirë që ju i shihni edhe rrugët që nuk janë të shtruara në fshatin Dobratin sepse shpesh herë kam marr kritika pikërisht prej juve që po shtroni rrugë shumë në fshatin Dobratin, kështu që po më vie mirë që e paskeni parë edhe ju një rrugë që nuk është shtruar. Sa i përket asaj rruge, deri tek Vrella është shtruar ndërsa në vitin e ardhshëm edhe ato 150 metra do të shtrohen, dhe së bashku do të shkojmë ta përurojmë sepse kam menduar unë edhe për atë, pastaj nuk është e vërtetë se ajo kompani i ka 20 të punësuar, nuk është me rendësi sa por shpresoj që t'i bëjë edhe 50, mirëpo e rëndësishme është që kemi për t'i ndihmuar që ti bëjnë edhe 100 punëtor sepse ata janë qytetarë tanë, madje të vendit prej ku unë jetoj së bashku me ata dhe veproj së bashku me ata, pra edhe për 100-150 punëtor do t'i ndihmoj ti punësoj ajo kompani sepse edhe unë jam në atë vend, kështu që vetëm me t'mira sepse të gjitha gjërat kanë për tu bërë mos u brengosni.

Kryesuesi i Kuvendit, meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën e vë në votim propozim vendimin në fjalë, sipas thirrjes dhe materiali përkatës.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 17 vota për, 14 vota kundër dhe 2 vota të përmbajtura, u miratua propozim vendimi për rialokimin e buxhetit të Komunës për vitin 2020, sipas materialit përkatës të dërguar.

2. Propozim vendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021

z.Isuf Latifi, drejtor i DBF, e paraqit fjalën hyrëse rreth propozim vendimit në fjalë, ndër të tjera theksoi, bazuar në Ligjin nr.06/L-005 mbi Tatimin në pronën e paluajtshme, paraqes para jush propozim-vendimin për caktimin e normave tatimore aktuale për vitin 2021. Bazuar në nenin 9 të Ligjit në fjalë, Kuvendi i Komunës i çdo Komune cakton normat tatimore për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë së pronave publike, deri më 30 nëntor të vitit para vitit të vendosjes së tatimit, në përputhje me këtë ligj. Kuvendi i Komunës duhet të rishikoj normat e caktuara dhe të caktoj norma të reja tatimore vetëm nëse një gjë e tillë kërkohet nga rrethanat, normat tatimore vendosen brenda kufijve të përcaktuar si më poshtë, dhe ato janë të vlefshme nga viti i ardhshëm fiskal, për njësitë buxhetore, për njësitë bujqësore të parcelave norma tatimore mund

të variojnë nga shkalla 0.15% deri në 0.5%, për njësitë bujqësore të objekteve norma tatimore variojnë nga 0.15% deri në 0.5%, në njësitë pyjore të parcelave norma tatimore mund të variojnë prej shkallës 0.15% deri në 0.3%, për njësitë rezidenciale të parcelave norma tatimore mund të variojnë në shkallën prej 0.15% deri në 1%, për njësitë rezidenciale të objekteve norma tatimore mund të variojnë prej 0.15% deri në 1%, për njësitë komerciale të parcelave normat tatimore mund të variojnë nga shkalla 0.15% deri në 1%, për njësitë komerciale të objekteve norma tatimore mund të lëvizin nga 0.15% deri në 1%, për njësitë industriale të parcelave norma tatimore mund të lëvizin nga 0.15% deri në 0.8%.

Nëse Kuvendi i Komunës nuk përcakton me kohë sipas afateve ligjore normat tatimore në përputhje me paragrafin 1 të nenit përkatës, Ministria e Financave aplikon normat e fundit tatimore të përcaktuara nga Kuvendi i Komunës për atë kategori përkatëse në rast se norma tatimore për atë kategori nuk është e caktuar, pra Ministria e Financave aplikon normën me të ulët tatimore të aplikueshme në përputhje me ligjin për atë kategori.

Të nderuar, ju informoj se vlerësimi për metër katror të të gjitha kategorive të pronave e kanë bërë kompanitë e licencuara dhe të kontraktura nga Ministria e Financave, duke pasur parasysh gjendjen e rënd ekonomiko-sociale të rënduar edhe nga pandemia për të cilën pasojat do t'i bartim edhe vitin tjetër, ne kemi bërë një propozim vendim me norma minimale për të gjitha llojet e pronave prandaj ju ftoj që të njëjtin ta shqyrtoni dhe miratoni.

z.Adnan Zymeri, theksoi, ashtu siç e prezantoi edhe drejtori i DBF, në ligjin nr.06/L-005, nenin 9 paragrafin 1 të këtij Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme, Grupi i këshilltareve nga radhët e LDK-së e përkrah propozim vendimin në fjalë për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021.

z.Bajram Ajeti, theksoi, sa i përket propozim vendimit për caktimin e normës së tatimit në fushat që edhe u ceken nga drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave mendoj se ka qenë e nevojshme të informohemi ne si anëtarë të Kuvendit sa ka qenë në pyetje realizimi i normave në tatim në vitin që jemi, sepse fundja edhe ligji ju obligon ngase në bazë të analizave që duhet t'i bëhen realizimit të normave tatimore gjatë vitit, nxjerrët edhe norma sepse ndoshta ndokund duhet të ngritë, ndokund duhet të ulët, andaj kërkoj që këtë informatë për, nëse ka mundësi të na paraqiteni tani.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, ne edhe në mbledhjen e kaluar të KPF-së diskutuam për norma tatimore, Ligji 06/L-005 i rregullon normat e tatimeve dhe aty përjashtimisht një pikë që flet për pronat - zonat industriale që është 0.8% deri në 20%, për të gjitha tjerat janë 0.1% deri në 0.15%.

Ne zonë industriale faktikisht nuk kemi dhe këto norma tatimore caktohen për çdo vit, andaj duhet t'i rregullojmë, ndoshta Kuvendi i ardhshëm për vitin tjetër, por drejtori i DBF e tha se jemi përcaktuar për normat më të ulëta, të jemi te qartë pra që ky Kuvend po merr vendim që normat tatimore në të gjithë në Podujevë do të jenë 0.1% sepse më e ulëta është ajo, kurse 0.15% është më e lartë, e them këtë sepse në Ligj thuhet, fillon nga 0.1% deri në 0.15%, ndërsa ajo që ne e themi është tjetër, pra unë po e them atë qka thuhet në Ligj, pra jemi tu fol për norma tatimore për njësitë komerciale dhe të tjerat, me përjashtim të pronave industriale e që ne nuk kemi zonë industriale por edhe aty duhet të përcaktohet një normë sepse nuk do të thotë që nuk bëhet, do të fillojnë 0.1% deri në 0.15%. Tani norma 0.1% është më e ulëta, kurse aty përcaktohet deri në 0.15% por duke filluar nga 0.15% deri në 0.1%, pra kështu thuhet, ndërsa tani a më e lartë është 0.15% apo 0.1%, për mua norma 0.1% është më e ulët se sa 0.15%, prandaj të jemi të qartë sepse materialet po sjellën me kohë por unë po e shoh që shumica e këshilltarëve nuk i kanë shtypur fare as materialet dhe nuk e kanë lexuar aspak atë vetëm po votojnë blanko e nuk e din çka po votojnë, ne nuk jemi për të mos i mbështetim normat tatimore e që sot do të vendoset në bazë të asaj që ne vendosim sepse ky është obligim ligjor dhe nuk mund ta lëmë që Ministria të vendos për Podujevën kur jemi këtu ne, por dua

të them që nëse është 0.15% atëherë shikojeni edhe ju se a është norma më e madhe apo më e vogël kjo para se të vendoset, sepse ligji e thotë se fillon nga 0.1% deri në 0.15% duke e përjashtuar zonën industriale që është 0.8% deri në 0.15%, prandaj nëse jemi në 0.15% unë e kuptoj që norma tatimore është më e larta, e jo më e ulëta, ndërsa nëse është 0.15% më e larta, të konsultohet edhe njëherë kjo çështje. Nuk jam për ta gjykuar drejtorin e DBF sepse është ekonomistë dhe e njeh këtë punë, por e shikova se çfarë thotë ligji dhe unë mendoj se të gjithë jemi përcaktuar që t'i lehtësojmë bizneset në këtë kohë pandemie pasi që nuk do ta dimë edhe vitin e ardhshëm se qysh do të jetë, të nxjerrim një mesatare të normave tatimore, nëse është 0.15% të paktën ta zbresim në 0.10%, pra të marrim një mesatare dhe të mos shkojmë as në maksimum e as në minimum, pra të jepet një sqarim teknik rreth caktimit të normës tatimore, përkatësisht përqindjes.

z.Isul Latifi, drejtor i DBF, sqarim parafolësit, theksoi, 0.15% apo nëse përkthehet në mënyrë më të thjesht po që se e marrim me euro është, 15 cent norma tatimore për metër katrorë është minimumi i të gjitha llojeve, por ka mundësi që të shkoj deri në 1 € për pronat rezidenciale sepse ekziston mundësia ligjore të shkojnë deri në 1 € për m², ne jemi përcaktuar për 0.15%, pastaj ka norma tatimore që mund të shkojnë edhe 0.80% apo që është 80 cent dhe 0.50% apo 50 cent. Pra 15 cent është norma më e ulët kurse norma më e lartë që është 1 € e që për të cilën kemi menduar që është shumë lartë dhe e pa përballueshme për çdo qytetarë të Komunës së Podujevës, madje edhe nëse e ka pozitën bukur të mirë materiale, 1€ për m² është normë shumë e lartë. Prandaj konsiderojmë se 1€ për m² është norma tatimore më e lartë dhe këtë e lejon ligji deri në atë masë, por ju këshilltarët e Kuvendit jeni ata që vendosni, pra si Ekzekutiv kemi propozuar 0.15% por Kuvendi Komunal është ai i cili e përcakton vlerën e normave tatimore deri në masën sa e lejon ligji nga minimumi deri në maksimum.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, nëse nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën rreth kësaj pike, unë e vë në votim sipas thirrjes dhe materialit të dërguar.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 23 vota për, asnjë votë kundër dhe 8 vota të përmbajtura, u miratua propozim vendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021, sipas materialit përkatës të dërguar.

3. Ngritja e Grupit punues për përgatitjen e draft - Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, e paraqiti një fjalë hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, lidhur me këtë çështje në mbledhjen e mbajtur me Komitetin për Politik dhe Financa e kemi bërë një rekomandim ku i kemi përcaktuar se kush do të jenë pjesë e këtij Grupit punues për përgatitjen e draft - Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021, kan mbetur për tu propozuar vetëm edhe dy nga Ekzekutivi i Komunës të cilët duhet të propozohen sot në mënyrë që ky Grup të përgatit një plan ashtu siç na ka hije si Kuvend i Komunës.

z.Fitim Muçolli, theksoi, në lidhje me planin e punës kanë qenë 32 pika të planifikuara për këtë vit janë realizuar vetëm 18 pika kurse të pa realizuara kanë mbetur 14 pika, prandaj mendoj se është e kotë nëse vetëm planifikohen me plan të punës por që këto nuk po realizohen, do të thotë i planifikoni por pavarësisht kësaj nuk po realizohen pikat përkatëse, pra mos na thirrni në takime nëse nuk i realizoni këto pika, por shpresoj që viti 2021 ka për të qenë 100% i realizueshëm për një arsye, sepse ne do të jemi në qeverisje.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, unë edhe njëherë do ti kisha lexuar përfaqësueset e propozuar për këtë komision, nga ana e LDK-së është propozuar që të jetë anëtare znj.Fatlume Jaha, nga VV-ja është propozuar që të jetë anëtarë z.Fitim Muçolli, nga grupi parlamentar i PDK-së është propozuar për anëtarë z.Fatmir Rudari, nga radhët e AAK-së është propozuar për anëtarë z.Patriot Rudari dhe kryesues i grupit unë Fatmir Gashi, a jeni për që së bashku me dy emrat që do ti propozojë ekzekutivi të ngritët ky komision.

z.Agim Blakçori, drejtor i Drejtorisë së Arsimit – DKA, theksoi, nga Ekzekutivi i Komunës së Podujevës, në Grupin punues në fjalë propozohen drejtorin e Drejtorisë së Administratës z.Gëzim Namani, dhe drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik z.Bunjamin Hoti.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, tani do e hedh në votim se kush është për që ky komision të punoj për Grupin punues për përgatitjen e draft - Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri u miratua ngritja e Grupit punues për përgatitjen e draft - Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021, përkatësisht propozimet për anëtar të këtij Grupi punues, në përbërjen si vijon:

1. z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, kryesues i Grupit punues
2. znj.Fatlume Jaha, nga radhët e LDK-së, anëtare
3. z.Fitim Muçolli, nga radhët e LVV-së, anëtar
4. z.Fatmir Rudari, nga radhët e PDK-së, anëtar
5. z.Patriot Rudari, nga radhët e AAK-së, anëtar
6. z.Gëzim Namani, nga radhët e Ekzekutivit të Komunës, anëtar/e
7. z.Bunjamin Hoti, nga radhët e Ekzekutivit të Komunës, anëtar/e

4. Të Ndryshme

znj.Lirika Maliqi, theksoi, kjo javë është një javë jo e zakonshme për ne si asamblist sepse nuk ka ndodh që të përballemi me zgjedhje për Kryetar të Komunës kur asambleja është ende funksionale andaj jemi në një mbledhje jo të zakonshme për ne si kuvendarë por edhe për qytetarët të cilët përveç halleve të tyre të përditshme me virusin e tyre dhe gjendjen ekonomiko-sociale tani kanë në dorë të vendosin edhe Kryetarin apo subjektin që do të qeverisë me Komunën e Podujevës në 9 muajt e ardhshëm, andaj nuk ka moment më të përshtatshëm mbi të gjitha që të ngrisim e të ri-ngrisim tema që preokupojnë qytetarin e zakonshëm në Komunën e Podujevës.

Në këtë asamble Kryetari i Komunës as që është interesuar që të merret me punët e asamblesë pra nuk ka dashur as t'i dëgjoi hallet e qytetarëve të cilët iu shërbejnë, konsiderojmë dhe kurdo që iu duhet i vërtetojmë se pavarësisht me dhjetëra e qindra kërkesa, ankesat dhe kritikën që kemi bërë në këtë Kuvend kanë mbetur këtu pa gjetur zbatim në politikën komunale, rinia jonë ka mbetur pa bibliotekë të mirëfilltë, pa qendër multifunksionale rinore, pa organizata rinore aktive dhe apolitike, pa kulturë dhe tanimë edhe pa sport të mirëfilltë sepse sport nuk është vetëm futbollit por janë një varg aktivitete sportive që me plotë gojë mund të them që janë shuar në Komunën e Podujevës, pavarësisht që talentët në ato fusha nuk kanë munguar nga radhët e të rinjve e të rejave në Komunën e Podujevës. Pastaj kemi subvencione të dhëna përmes ndotësive, përkrahje vetëm për militant, rininë keni tentuar ta nënshtroni përmes presioneve të ndryshme si në biznes ashtu edhe ta kushtëzoni për bursa, punësime dhe në çdo gjë tjetër që ju keni pasur në dorë mbi 20 vite qeverisje një partiake, autokraci e asfalt, prandaj ka ardhur dita që të ndryshojmë për të parë diçka ndryshe nga

qeverisjet e deritanishme, ndoshta kjo edhe do t'ju ndihmoj juve LDK-së si subjekt, e në veçanti individëve që kanë kapur LDK-në, që të kuptojnë që qytetaret e Llapit e Gollakut nuk janë marionetë e klaneve biznesore e politike por kanë dinjitet dhe duan që të respektohen ëndrrat, dëshirat dhe vullneti i tyre, e kjo natyrisht që do të ju ndihmoj që ta kuptoni njëherë e përgjithmonë që në vitin 2020 dhe në shekullin XXI, asfalti e ndriçimi nuk janë luks apo favor që ju i bëni qytetarëve por janë baza e qeverisjes së përgjithshme dhe kanë obligim ligjor e moral ndaj qytetarëve që paguajnë taksa për të marr këto shërbime. Mjaft më me kinse favore përmes parasë publike, shërbimet komunale janë të natyrshme pra janë baza e funksionimit të Komunës dhe për këtë duhet të përfitojnë qytetarët e Podujevës, buxheti i Komunës nuk duhet të vidhet, nuk duhet të keqpërdoret, nuk duhet të shërbej për disa individë apo të shpërndahet në baza partiake por do të duhet t'ju shërbej të gjithëve sipas nevojave prioritare dhe të sjell zhvillimin dhe mirëqenien për mbarë Podujevën, uroj të keni shëndetin dhe shihemi në mbledhjen e ardhshme si opozita më e re në Republikën e Kosovës.

znj. Adelina Stublla, theksoi, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit z. Agim Blakqori, shkolla fillore “Enver Maloku” thuajse që një vit është pa sekretar të shkollës prej kur që sekretarja e kësaj shkolle ka dalë në pension, pyetja është pse nuk është hapur konkurs deri më tani apo ndoshta jeni duke ruajtur për ndonjë militant të juaj. Po ashtu në oborrin e kësaj shkolle ekziston një shtëpi ku pronari i saj ka thyer murin për të hapur lokal me ushqime të shpejta për nxënësit dhe mësimdhënësit, ne nuk jemi kundër shërbimeve të nxënësve dhe stafit të shkollës, por mirë do të ishte që nxënësit e çdo shkolle të kishin suita ditore që të jenë të barabartë mes vete, e pyetja është a jeni në dijeni ju i nderuari drejtor dhe a ka marr leje nga Komuna për këtë biznes, a paguan tatim apo i paguan drejtorit të shkollës “Enver Maloku”, nëse po ku janë destinuar dhe ku po destinohen këto të holla, a keni ndonjë raport të destinimit të këtyre mjeteve.

Pyetja e radhës është, në Gjimnazin “Aleksandër Xhuvani”, shkollë e cila ka rreth 2000 nxënës e që tani më është bërë një vit që ajo shkollë nuk ka zëvendës drejtor ndërsa konkursi është hapur para rreth dy muajve që i bie pas një viti pas një viti por që ai konkurs sërish është anuluar, përse nuk është rihapur sërish konkurs për këtë pozitë.

Po ashtu kam edhe një shqetësim, jemi në prag të stinës së dimrit e jo të gjithë i gëzohen ardhjes së dimrit, po të shkojmë në periferi të qytetit konkretisht në Lagjen e Dëshmorëve mund të shohim se si qytetarët tanë vazhdojnë të banojnë në kontejnerët e improvizuar si banesa asokohe nga donatorët arab, e që banore e atyre kontejnerëve është edhe një lehonë e cila e ka gjendjen shumë të rendë ekonomike dhe shëndetësore, përkundër kësaj ajo është e detyruar të mbijetoj disi, fatin e saj për mbijetesë e kanë edhe disa banorë të tjerë, shtëpitë e të cilëve ka herë janë ndërtuar ndërsa Ekzekutivi në ikje po i lë ato si dekorime në vitrina, pyetja është pse nuk po vendosen ato familje nëpër shtëpi që iu kanë premtuar apo po e përdorni edhe mjerimin e tyre për të siguruar vota në prag të zgjedhjeve.

z. Fitim Muçolli, theksoi, kam pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, me datë 23.07.2020 është shpallur konkursi për mësimdhënës për gjuhë gjermane, keni kërkuar 6 mësimdhënës, me datën 15.09.2020 e keni pranuar vetëm një mësimdhënës, pyetja ime është çka ka ndodhur me 5 mësimdhënës të tjerë dhe kush po i mban orët e këtyre mësimdhënësve, a po i mbanë dikush ato orë apo nxënësit po i lëni jashtë mësimi, pra a mendoni se pa ata 5 mësimdhënës sa orë janë të humbura dhe nxënësit mbesin jashtë objekteve shkollore.

z. Pajtim Hodolli, theksoi, kohëve të fundit po e shohim që Komuna është shumë aktive me asfaltimin e rrugëve dhe desha të i shprehë disa pakënaqësi të qytetarëve përveç që rrugët po shtrohen pa kritere, urat po shtrohen apo po ndërtohen shabllon pavarësisht se në një vend sa ka lumi ujë apo nuk ka fare ujë me të njëjtin kriter po ndërtohen.

Po ashtu pas konsultimit me disa ekspert të komunikacionit ndër ta edhe profesorin Faton Bunjaku, kam vërejtur që shumë vende, edhe pse rrugët janë ndërtuar, janë vendosë shenjat e komunikacionit të cilat janë pa kurrfarë kriteresh dhe pengojnë qarkullimin e veturave gjë e cila vlen edhe për pjesën e qendrës, shembull, këtu ku nuk ka vend për stacion të autobusëve dhe disa shenja janë të vendosura, disa shenja janë njëra mbi tjetrën, pra janë vendosur më shumë se 3 shenja me një vend e që nuk i plotësojnë kriteret e parapara në bazë të rregullave të komunikacionit.

Përveç këtyre unë e kam parë edhe njoftimin që e ka publikuar komuna për listën përfundimtare të përfituesve të subvencioneve dhe desha të ia bëjë një pyetje drejtoreshës së Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, pse nuk i publikon edhe mjetet se nga sa janë subvencionuar këto klube, shembull, dua ta di sa është subvencionuar klubi i djalit të z.Agim Veliut, klubi “Dardanët” dhe sa është subvencionuar një klub tjetër, pra t’i dimë shumat për ato klube.

z.Vendenis Lahu, theksoi, kam një pyetje konkrete për drejtorinë e DKA-së edhe pse deri më tani asnjëherë nuk na është përgjigjur në asnjë nga pyetjet që kemi parashtruar, pyetja ime është, pse nuk e keni sjellë raportin për fillimin e vitit të ri shkollor në Komunën e Podujevës, janë bërë muaj të tërë dhe nuk e keni sjellë, madje keni bllokuar edhe iniciativën tonë të propozuar në KPF për të shtjelluar si pikë të rendit të ditës, kurse aq keq që është gjendja e dimë të gjithë madje sa nuk po mund të raportoni për punët, sepse unë e di që është aq keq sa është degraduar arsimi të cilin e përsërisë që e keni degraduar gjë të cilën e kam parë edhe vet, jo vetëm sa për të fol nga vetëm prej përshtypjeve të jashtme por kam qenë dhe në disa procese të rekrutimit të cilat kanë qenë skandaloze dhe nëse dëshironi të dini drejtor që arsimi është keq dhe që e keni degraduar është pikërisht përmes punësimeve pa kriter, ose në fakt me kriter por kriteret janë jo konvencionale, kriter i të qenit partiak apo mbi baza partiake, prandaj se qysh është gjendja në arsim përse nuk po raportoni.

z.Hasan Ajeti, theksoi, vetëm desha me t’ia uroj z.Vendenis Lahu specializimin në fushën e Kardiologjisë dhe është një lajm i mirë që lexohet që arsimi në Komunën e Podujevës nuk është bash keq, suksese i nderuar.

z.Bajram Ajeti, theksoi, desha vetëm të shtroj një pyetje po meqenëse nuk e kemi drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit e që më vie shumë keq por vetëm desha ta të pyes se, për sa vota po shitet m² e zhavorrit e asfaltit, kjo po na intereson ta dimë nga sa vota.

z.Vendesni Lahu, theksoi, më shtyri të bëjë replikë me parafolësin z.Hasan Ajeti të cilin e falënderoj për urimin, por po e ndaj një histori ndoshta pak personale me ju, pikërisht është kjo sallë ku po i mbajmë mbledhjet që për herë të parë kur isha në klasë të VII-të në një garë komunale me arsimin e ciklit të mesëm të lartë dhe isha më i riu në moshë por që kam dal i pari, zakonisht gjithmonë kam dal i pari, dhe besoj se edhe kësaj radhe do të dal i pari kështu që faleminderit shumë.

Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:25

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.01-060/01-0071475/20

Podujevë,

23 nëntor 2020

Kryesuesi i Kuvendit

Fatmir Gashi